



Gjuajtje me armë si në filma në Prishtinë: Shtetasit britanik gjuhen me armë nga një veturë në lëvizje



LAJME

24/08/2023 09:14



Tre shtetas britanik kanë raportuar se sa ishin në lëvizje me veturë persona të panjohur kanë shtënë me armë në drejtim të tyre.

Nga gjuajtja me armë lëndime të lehta trupore ka pësuar njëri nga ta, ndërsa në vendin e ngjarjes janë gjetur tri gëzhoja të pistoletës, shkruan lajmi.net.

Policia ka njoftuar se për këtë rast është intervistuar një i dyshuar të cilit i është konfiskuar një pistoletë, e më pastaj është liruar në procedurë të rregullt.

“Tre viktimat meshkuj me shtetësi Britanike, kanë raportuar se persona të panjohur, nga një veturë në lëvizje kanë shtënë me armë zjarri në drejtim të tyre dhe si pasojë njëri prej tyre ka pësuar lëndime të lehta trupore. Në vendin e ngjarjes janë gjetur tri gëzoja të pistoletës. Lidhur me rastin është intervistuar një i dyshuari mashkull kosovar, dhe nga ai është konfiskuar një pistoletë. Me vendim të prokurorit i dyshuari është liruar dhe rasti shkon në procedurë të rregullt”, thuhet në raportin e Policisë.

Artikuj të ngjashëm



August 24, 2023

Bie niveli i ujit në Kanalin e Panamasë – bllokohen 200 anije



August 24, 2023

Ferizaj: Një femër vdes në Klinikën Emergjente, Policia nis hetimet



August 24, 2023

Peci del në terren, thotë se prona afër AAK-së është e uzurpuar



August 24, 2023

Lipjan: Burri dhe gruaja braktisin fëmijën



August 24, 2023

E tmerrshme: Dhunohet një femër në Istog, arrestohet i dyshuari



August 24, 2023

Vdekja e një pacienti në klinikën e Psikiatrisë, deklarohet Policia

LAJME TË FUNDIT



Bie niveli i ujit në Kanalin e Panamasë – bllokohen 200 anije



“Këtu nuk je në Serbinë tënde të ndyrë”...



Ballkani – BATE Borisov: Ekipi bjellorus në formë...



Peci del në terren, thotë se prona afër AAK-së është e uzurpuar